



**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN TEMATIK “MBI
ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
PERFORMANCËS TË EVADUAR NË GJASHTË MUJORIN E DYTË
TË VITIT 2023**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK
“MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E
PERFORMANCËS TË EVADUAR NË GJASHTË MUJORIN E DYTË TË
VITIT 2023”**

MBI AUDITIMIN ME TEMË: “Performanca e ofrimit të shërbimeve online”

NË SUBJEKTIN:

AGJENCIA KOMBËTARE E SHOQËRISË SË INFORMACIONIT

PRILL 2025

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE:..... | 3 |
| 1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit..... | 3 |
| 2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh..... | 3 |
| 3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh..... | 3 |
| 4. Statusi i pranimit të rekomandimeve..... | 3 |
| II. HYRJA..... | 4 |
| II.1 Objekti auditimit:..... | 4 |
| II.2 Qëllimi auditimit..... | 4 |
| II.3 Metodologjia e auditimit: | 4 |
| II.4 Konkluzioni..... | 4 |
| II.5 Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna..... | 5 |
| III. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm..... | 5 |
| IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME..... | 16 |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH), në zbatim të programit të auditimit nr. 1489, prot., datë 12.12.2024 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduara në 6-mujorin e dytë të vitit 2023”, ushtroi auditim në 1 subjekt auditimi pjesë e Auditimit të Performancës me temë “Performanca e ofrimit të shërbimeve on-line”, përkatësisht Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Auditimi i kryer në vitin 2023, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2022 dhe konkluzionet e tij janë miratuar me **Vendimin Nr. 228 datë 27.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së** si dhe i janë përcjellë Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr. 443/6 prot., datë 27.12.2023 duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me: Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna u krye nga data 16.12.2024 deri më datë 17.01.2025, duke i kushtuar vëmendjen e posaçme çështjeve, që lidhen me:

- Vlerësimin e rekomandimeve të KLSH-së të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2023, hartimi i programeve (plan veprimeve) nga subjekti i audituar, duke ngarkuar me detyra personat përgjegjës dhe përcaktuar afatet konkrete për zbatimin e rekomandimeve për çdo njësi vartëse;
- Nxjerrjen nga Titullari i njësisë publike të akteve administrative të nevojshme, si vendime, urdhër për zbatimin e masave organizative;
- Të tjera masa e rekomandime që i përcillen subjektit të audituar nëpërmjet Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në subjektin e audituar u mbajt Akt-Verifikimi përkatësisht:

-Akt-verifikimi nr. 6516/1 prot, datë 15.01.2025.

- Observacion nr.6516/3 date 25.03.2025 derguar nga AKSHI lidhur dhe Projekt Raportin dhe protokolluar me tonën nr.1489/2 date 03.04.2025.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh

Në zbatim të nenin 15, shkronja "j" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për informimin e KLSH-së, mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna, rezultoi:

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka dërguar me shkresën nr. 2353/10, prot., datë 05.01.2024 planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH – së për rekomandimet, protokolluar me tonën me nr. 443/7, prot., datë 09.01.2024.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh

Për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna, në zbatim të nenit 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", i cili përcakton se: "Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna". Nga verifikimi mbi zbatimin respektimin e këtij afati rezultoi se:

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk ka respektuar afatin ligjor prej 6 muajsh për raportimin në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna.

4. Statusi i pranimit të rekomandimeve

Sipas shkresave përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit administruar në KLSH me nr. 443/6 prot., datë 27.12.2023 janë rekomanduar gjithsej:

✓ Masa organizative 9 rekomandime

Sa i takon statusit të pranimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi, si dhe në mungesë të informimit dhe raportimit në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna rezulton se:

| Nr. | Lloji i rekomandimit | Rekomanduar | Pranuar | Pa pranuar |
|-----|----------------------|-------------|---------|------------|
| 1 | Organizative | 9 | 9 | 0 |

II. HYRJA

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në vitin 2023, është kryer në përputhje me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe manualit “Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit lënë subjekteve të audituara dhe regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve” miratuar me shkresën nr. 341/17 prot., datë 13.06.2021.

Auditimi u krye në bazë të Programit të Auditimit 1489, prot., datë 12.12.2024 “Mbi auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e performancës të evaduar në 6-mujorin e dytë të vitit 2023” për Auditimin e Performancës me temë “**Performanca e ofrimit të shërbimeve on-line**”.Konkluzionet përkatëse janë miratuar me Vendimin Nr. 228 datë 27.12.2023 të Kryetarit të KLSH-së dhe janë përcjellë në subjektin e audituar me shkresën nr. 443/6 datë 27.12.2023.

Auditimi u krye nga Grupi i Audituesve Shtetërore të KLSH, i përbërë:

1. A. Ç., *përgjegjës grupi*
2. R. L., *anëtar*.
3. A. T., *anëtar*

Auditimi ka filluar më, 16.12.2024

Auditimi ka përfunduar më, 17.01.2025

II. 1. Objekti i auditimit

Zbatimi i masave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm të dërguara në Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit me shkresën nr 443/6 prot., datë 27.12.2023, së bashku me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

II. 2. Qëllimi auditimit

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve, kryhet në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, bazuar në pikën 3 e nenit 31, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

II. 3. Metodologjia e auditimit

Auditim i plotë i gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH-ja për përmirësimin e gjendjes së subjektit në të ardhmen.

II. 4. Konkluzioni

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e auditimit, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja me shkresën nr 443/6 prot., datë 27.12.2023, rezulton se **9 (nëntë) masat e rekomanduara** janë pranuar nga subjekti i audituar. Nga këto masa:

- ✓ është zbatuar **1 rekomandim** ose 11% e tyre

- ✓ nuk janë zbatuar **6 rekomandime** ose 67% e tyre,
- ✓ është zbatuar pjesërisht **2 rekomandime** ose 22% e tyre.

| Nr. | Lloji i Rekomandimit | Zbatuar | Pa Zbatuar | Në proces zbatimi | Pjesërisht i zbatuar | Total |
|-----|----------------------|----------|------------|-------------------|----------------------|----------|
| 1 | Masa organizative | 1 | 6 | 0 | 2 | 9 |
| | Gjithsej | 1 | 6 | 0 | 2 | 9 |

Në numër dhe në % statusi i masave paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Statusi i masave organizative | Në numër | Në % |
|-----|-------------------------------|----------|--------------------------------|
| 1 | Totali | 9 | 100 |
| 2 | Pa pranuar | | |
| 3 | Pranuar | 9 | 100 |
| | Nga të pranuarat: | | Në % ndaj të pranuarave |
| 1 | - Zbatuar Plotësisht | 1 | 11% |
| 2 | - Zbatuar pjesërisht | 2 | 22% |
| 3 | - Në proces zbatimi | | |
| 4 | - Pa zbatuar | 6 | 67% |

II. 5. Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna

Pavarësisht nga puna e bërë, ku niveli i zbatimit të rekomandimeve është rreth **11%**, për disa nga masat organizative Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk ka mundur realizimin e tyre. Rëndësia dhe ndjeshmëria e temës objekt auditimi kërkon më tepër impenjim nga subjekti i audituar për përmbushjen e rekomandimeve të lëna.

III. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Më konkretisht, ecuria e zbatimit të rekomandimeve të lëna paraqitet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. A kanë prodhuar politikat e ndërmarra një mekanizëm efektiv për ofrimin e shërbimeve on line për qytetarët dhe bizneset?

Nën pyetja 1.1.1: A mbështesin dokumentet politikë një vizion të qartë për digjitalizimin e shërbimeve publike?

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën në auditim për vitet 2020-2022 nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit krahas punës së bërë në drejtim të përmirësimit të dokumenteve strategjike për digjitalizimin e shërbimeve publike u konstatua disa mangësi në procesin e:

- hartimit të planeve të monitorimit për realizimin e Programit Kombëtar TIK 2018-2021,
- dhënies së shpjegimeve të përgjithshme të Agjendës Digjitale 2022-2026 për shërbimet publike, on-line për qytetarët dhe bizneset.

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të përfshira në Agjendën Digjitale Shqipëri 2022-2026, të marrin masa të hartojnë Plane Monitorimi vjetore për analizimin dhe realizimin e aktiviteteve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komentet e subjektit të audituar:

AKSHI gjithmonë ka pasur dhe ka në fokus qasjen dhe përshtatjen e politikave dhe praktikave më të mira të rajonit në lidhje me zhvillimet inovative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike në tërësi.

Në vitin 2018, AKSHI ka miratuar me Urdhër nr.6244, datë 07.11.2018 “Programin Kombëtar TIK 2018-2021”, i cili është hartuar për të siguruar vazhdimësinë e politikave ekzistuese TIK, për të përcaktuar prioritetet qeveritare në fushën TIK si dhe për të bashkërenduar strategjinë ndërinstucionale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike, për qytetarët, si dhe subjektet private për periudhën 2018 – 2021.

Drejtoria e Inovacionit dhe Promovimit të e-Gov (tashmë, me ndryshimin e strukturës, Drejtoria e Koordinimit të Agjendës Digjitale dhe Projekteve e-Gov me Fonde të Huaja) e cila është përgjegjëse për monitorimin e realizimit të Programit Kombëtar TIK 2018-2021 dhe të Agjendës Digjitale, ka hartuar një raport-analizë për Programin Kombëtar TIK të cilin do ta gjeni bashkëlidhur të titulluar “Revolucioni digjital arritjet dhe sfidat”.

Ndërkohë lidhur me Agjendën 2022-2026 është hartuar Raporti i monitorimit për vitin 2022 (6-mujori), raporti i monitorimit për vitin 2023 dhe raporti i monitorimit për vitin 2024 (6 mujori) të cilat po ja u vendosim në dispozicion bashkëlidhur.

Theksojmë se, këto raporte janë hartuar në bashkëpunim me institucionet kontribuese të përfshira në agjendë dhe në planin e veprimit.

Bashkëlidhur do të gjeni raportet.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi vlerësohet, **i pranuar dhe i zbatuar.**

Statusi i rekomandimit : i zbatuar

2.Gjetje nga auditimi: Për periudhën në auditim për vitet 2020-2022 krahas punës së bërë në përcaktimin e roleve dhe përgjegjësive të institucioneve publike në ofrimin e shërbimeve on line për disa institucione u konstatua :

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me gjithë marrjen e masave të vazhdueshme për rritjen e numrit të vendeve të punës, vijon të ketë mangësi të burimeve njerëzore dhe ekspertë të fushës,

- mos përditësimi i rregullores së brendshme, me ndryshimet përkatëse të strukturës,

- mos pajisja me Certifikatën e Sigurimit e gjithë punonjësve të cilët përpunojnë informacionin e klasifikuar,

- mos kryerja e trajnimeve të vazhdueshme të stafit në përshtatje me njohuritë e fundit të teknologjisë digjitale.

2.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa të plotësojë të gjitha vendet bosh të punës sipas organikës së institucionit, për përditësimin e rregullores së brendshme dhe të hartojë planin vjetor të trajnimeve për zhvillimin e burimeve njerëzore me tema të mirë përcaktuara, sipas zhvillimit të teknologjisë dhe për gjithë punonjësit.

Menjëherë

Shpjegimet e subjektit të audituar

Gjatë vitit 2023 janë shpallur disa herë vendet vakante përkatësisht për pozicionet vakante ku në shumicën e rasteve janë mbyllur ose pa asnjë aplikues ose pa asnjë fitues për shkak të mosplotësimit të kriterëve/kërkesave të përcaktuara në njoftim për vend të lirë pune.

Vendosja në efikasitet e të gjithë sektorëve dhe drejtorive përkatëse që kanë pozicione vakante është gjithmonë një ndër prioritetet kryesore, në përmbushje të objektivave dhe fushë përgjegjësisë së AKSHI-t.

Theksojmë se, në vitin 2024 janë plotësuar 30 pozicione si në AKSHI-in qëndror ashtu dhe në Drejtoritë/sectorët e atashuar nëpër institucione.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit ka në fokus të vijueshëm dhe prioritar plotësimin e vendeve vakante sipas organikës së institucionit dhe e ka pasur këtë fokus përgjatë gjithë veprimtarisë së saj. AKSHI është i angazhuar dhe po publikon e do vijojë në vazhdimësi të bëj publikimin e shpalljeve për plotësimin e vendeve vakante në organikë.

Në muajin Shtator 2024 u miratuan shtesat dhe ndryshimet në Ligjin nr.43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”. Për shkak të përcaktimeve ligjore në ligj AKSHI po rishikon strukturën dhe organikën e brendshme dhe për rrjedhojë do të duhet të shikojmë dhe përshkrimet e punës ku të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për secilin pozicion.

Me miratimin e strukturës së re do të përfundojë dhe hartimi i rregullores së brendshme.

AKSHI ndjek dhe angazhon vazhdimisht stafin e tij në trajnime dhe thirrje të ndryshme për trajnim si ato të ofruara brenda vendin ashtu dhe jashtë vendit. Trajnime për personelin e IT të deleguar në institucione dhe ata prezent të AKSHI mbi të gjitha temat që janë pjesë e fushëpërgjegjësisë së AKSHI-t dhe për të gjitha strukturat organizative të institucionit.

Trajnimet janë të skeduluara gjatë harkut kohor vjetor, si dhe AKSHI angazhon stafin e tij në konferenca, ëorkshop-e, etj., të ofruara nga partnerët ndërkombëtarë.

Theksojmë se, kapacitetet teknike të punonjësve të AKSHI-t janë rritur dhe do të vijojnë të rriten edhe më tej falë bashkëpunimit me Microsoft nëpërmjet programit “*Training over the shoulder*”, ku përfaqësues të tyre do të punojnë krah për krah me stafin e AKSHI-t. Një tjetër projekt në zhvillim është ai i bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët do të ndihmojnë me fonde për trajnim dhe certifikim të punonjësve të Drejtorisë së Monitorimit dhe Mbrojtjes Kibernetike për teknologjitë më të fundit të mbrojtjes.

Pra, ky rekomandim është në proces përmbushjeje.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezultoni pranuar dhe **pjesërisht i zbatuar**.

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjekti i audituar mbi projektraportin e dërguar.

AKSHI ka paraqitur observacion nr.6516/3 date 25.03.2025 lidhur dhe Projekt Raportin dhe protokolluar me tonën nr.1489/2 date 03.04.2025 të mbajtur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Komente të paraqitura nga AKSHI

Gjatë vitit 2023-2025 janë shpallur disa herë vendet vakante përkatësisht për pozicionet vakante ku në shumicën e rasteve janë mbyllur ose pa asnjë aplikues ose pa asnjë fitues për shkak të mosplotësimit të kriterëve/kërkesave të përcaktuara në njoftim për vend të lirë pune.

Theksojmë se, në vitin 2024 -03 Mars 2025 janë plotësuar 50 pozicione si në AKSHI-in qëndror ashtu dhe në Drejtoritë/sectorët e atashuar nëpër institucione.

Për shkak të përcaktimeve ligjore në ligj AKSHI po rishikon strukturën dhe organikën e brendshme dhe për rrjedhojë do të duhet të shikojmë dhe përshkrimet e punës ku të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për secilin pozicion.

Trajnimet janë të skeduluara gjatë harkut kohor vjetor, si dhe AKSHI angazhon stafin e tij në konferenca, ëorkshop-e, etj., të ofruara nga partnerët ndërkombëtarë.

Theksojmë se, kapacitetet teknike të punonjësve të AKSHI-t janë rritur dhe do të vijojnë të rriten edhe më tej falë bashkëpunimit me Microsoft nëpërmjet programit “*Training over the shoulder*”, ku përfaqësues të tyre do të punojnë krahas me stafin e AKSHI-t.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Subjekti i audituar nuk ka paraqitur asnjë koment ndryshe nga qëndrimet e mëparshme sa me sipër statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar

3. Gjetje nga auditimi: Monitorimi deri në muajin shtator të vitit 2022, për ofrimin e shërbimeve publike on-line nga institucionet shtetërore, të cilat ndërveprojnë në platformën e-Albania, sipas Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik, e kanë realizuar vetë institucionet jo në koordinim me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

3.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Informacionit dhe Komunikimit të shtojë bashkëpunimin me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, për monitorimin e vazhdueshëm të shërbimeve publike të ofruara nga institucionet shtetërore.

Në vijimësi

Shpjegimet e subjektit të audituar:

AKSHI ka bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ndërsjelltë me institucionet shërbim ofruese dhe institucionet që monitorojnë këto të fundit duke qenë se veprimtaria e të gjithëve duhet të jetë në sinkronizim dhe e lidhur në shërbim të qytetarëve dhe biznesit për të ofruar shërbimet elektronike. Për më tepër këto funksione të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje realizohen në përmbushje dhe zbatim të dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin e Bashkëqeverisjes.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Statusi i rekomandimit: Pjesërisht i zbatuar.

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezultoi i pranuar dhe **pjesërisht i zbatuar**.

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjekti i audituar mbi projektraportin e dërguar.

Komente të paraqitura nga AKSHI

AKSHI ka bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ndërsjelltë me institucionet shërbim ofruese dhe institucionet që monitorojnë këto të fundit duke qenë se veprimtaria e të gjithëve duhet të jetë në sinkronizim dhe e lidhur në shërbim të qytetarëve dhe biznesit për të ofruar shërbimet elektronike. Për më tepër këto funksione të Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje realizohen në përmbushje dhe zbatim të dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin e Bashkëqeverisjes.

Pra, bashkëpunimi për përmbushjen e afateve të shërbimeve publike elektronike dhe monitorimin e tyre duhet të kryhet nga vetë institucionet dhe ADB-ja dhe jo nga AKSHI pasi kjo gjë kalon përtej detyrimeve dhe kompetencave ligjore të AKSHI-t.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Subjekti i audituar nuk ka ndërmarre asnjë hap për të shtuar bashkëpunimin me ABD,sa me sipër statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar.

Pyetje e auditimit 2: A kanë mbështetur masat organizative dhe teknike zbatimin e plotë të mekanizmit të marrjes së shërbimeve publike on-line për qytetarët dhe bizneset?

Nën pyetja 2.1.1: A janë marrë masat e nevojshme nga institucionet publike për të garantuar ofrimin efektiv të shërbimeve on-line?

4. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me procesin e digjitalizimit dhe konkretisht për vitin 2022 rezultoi se janë ngritur vetëm 2 sisteme të reja që i përkasin shërbimeve që ofron MSHMS (të trajtuara më lart) dhe për 8 institucionet e tjera janë kryer përmirësime të sistemeve elektronike ekzistuese të cilat sipas shifrave të buxhetit marrë nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për vitin 2022 kanë vlerën e 2,324 miliardë lekë investime.

-Nuk rezulton të ketë gjurmë informacioni në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe as bashkëpunim ndër institucional në lidhje me përshtatjen e këtyre risive në infrastrukturën përkatëse TIK si nga administrata shtetërore ashtu edhe nga qytetarët apo bizneset duke krijuar mangësi si në monitorimin e efektivitetit të këtyre sistemeve ashtu edhe në zgjidhjen në kohë reale të problematikave që kanë qytetarët.

- Asnjë institucion nuk ka sjellë kërkesa me shkrim pranë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për nevojat e tyre për projektet dhe pajisjet TIK për vitin pasardhës, sipas afateve ligjore, brenda datës 30 qershor¹ të çdo viti.

4.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të hartojë raporte periodike 3 mujore mbi ecurinë dhe përshtatjen e përmirësimeve që kryhen në sistemet TIK nga institucionet që ofrojnë shërbime të ndryshme on –line ndaj qytetarëve dhe të njoftojë Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Në vijimësi

Shpjegime të dërguara nga AKSHI:

Aktualisht nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania ofrohen 1247 të shërbimeve publike në mënyrë elektornike. Në nenin 25 - 29 të ligjit Nr.43/2023 ‘Për Qeverisjen Elektronike’, të ndryshuar, përcaktohen detyrat e AKSHI-t si ofrues shërbimesh, si krijues zhvillues dhe administrues i sistemeve dhe infrastrukturave, si kontribues në hartimin e politikave në fushën TIK, detyra në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare, si dhe detyra të tjera të AKSHI-t. AKSHI është një institucion i administratës shtetërore, në varësi të Kryeministrit dhe sikundër ofron shërbime elektronike publike nëpërmjet portalit e-Albania, publikon listën e të gjitha shërbimeve sëbashku me të gjithë informacionin e specifikuar për secilin shërbim ku përfshihet në mënyrë të detajuar, baza ligjore, mënyra e aplikimit për marrjen e shërbimit, institucionin përgjegjës për trajtimin e aplikimit, afatet dhe të gjitha informacionet e tjera të domosdoshme për qytetarët dhe bizneset.

Sqarojmë se, paraqitja e kërkesës pranë AKSHI-t për përditësim të shërbimit online në rast se baza ligjore mbi të cilën funksionon ai shërbim ka përsuar ndryshime është përgjegjësi e drejtëpërdrejtë e institucionit që ofron shërbimin në përputhje me përcaktimet ligjore të pikës 5, të nenit 7 të VKM

¹ VKM nr. 673, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, datë 22.11.2017, i ndryshuar, Kap II, pika 5.1/i

nr.1147/2020 , sipas së cilës: “Për përditësimin e shërbimeve elektronike, institucioni ofrues i shërbimit i përcjell AKSHI-t kërkesën për ndryshimet përkatëse brenda 3 (tri) ditëve pune nga hyrja në fuqi e ndryshimeve ligjore apo procedurale.”

Në kuptim të sa më sipër, AKSHI nuk ka as detyrimin ligjor por as edhe kapacitetet njerëzore për të evidentuar çdo bazë ligjore që ndryshohet nga institucionet shërbim ofruese.

Gjithashtu, nga ana e AKSHI-t janë marrë të gjitha masat e nevojshme në respektim të të gjitha afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për ofrimin e zgjidhjes teknike në përmbushje të çdo kërkesë që është paraqitur nga institucionet shërbimofruese.

Theksojmë se, përshtatja apo përmirësimi i sistemeve elektronike realizohet bazuar në një kontratë të lidhur mes palëve dhe monitorimi i ecurisë është një çështje që trajtohet në marrëdhënien kontraktuale ndërmjet kontraktorit dhe kontraktuesit.

Pra, AKSHI nuk ka asnjë tagër ligjor që të funksionojë ose të operojë jashtë apo mbi kushtet e një kontratë të lidhur dhe ligjërish të vlefshme dhe për më tepër të raportojë pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pazbatuar**.

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjekti i audituar mbi projektraportin e dërguar.

Komente të paraqitura nga AKSHI

Në kuptim të sa më sipër, AKSHI nuk ka as detyrimin ligjor por as edhe kapacitetet njerëzore për të evidentuar çdo bazë ligjore që ndryshohet nga institucionet shërbim ofruese.

Gjithashtu, nga ana e AKSHI-t janë marrë të gjitha masat e nevojshme në respektim të të gjitha afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për ofrimin e zgjidhjes teknike në përmbushje të çdo kërkesë që është paraqitur nga institucionet shërbimofruese.

Theksojmë se, përshtatja apo përmirësimi i sistemeve elektronike realizohet bazuar në një kontratë të lidhur mes palëve dhe monitorimi i ecurisë është një çështje që trajtohet në marrëdhënien kontraktuale ndërmjet kontraktorit dhe kontraktuesit.

Pra, AKSHI nuk ka asnjë tagër ligjor që të funksionojë ose të operojë jashtë apo mbi kushtet e një kontratë të lidhur dhe ligjërish të vlefshme dhe për më tepër të raportojë pranë Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Subjekti i audituar nuk ka ndërmarre asnjë hap për të zbatuar rekomandimin mbi hartimin e raporteve periodike , sa me sipër pretendimi i dhënë nuk merret në konsideratë dhe statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar.

5.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me korrespondencën shkresore të institucioneve shtetërore me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit u konstatuan:

-Mos respektimi i afateve ligjore në kohë në lidhje me detyrimin që institucionet shtetërore kanë për sjelljen e ndryshimeve ligjore të cilat duhet të reflektohen në formularin elektronik nga Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, që të mos penalizohen qytetarët dhe bizneset. Konkretisht:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka dërguar me rreth 2 vite vonesë formatin elektronik për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore nga dalja e Urdhrit nr. 284, datë 07.10.2020 “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore”;

- Drejtoria e Përgjithshme Detare ka përcjellë shkresën me nr. 7997.prot., datë 21.12.2022, në zbatim të Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2022 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për përditësimin e shërbimit që lidhet me aplikimin për regjistrim dhe pajisje me pasaportë detare dhe aplikimin për regjistrim dhe pajisje me pasaportë detare për shtetas shqiptarë, të huaj, pa shtetësi” rreth 6 muaj me vonesë;

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në zbatim të urdhrat të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 61, datë 05.06.2012, i rishikuar me urdhrat nr. 432/1, datë 17.02.2017 dhe nr. 392, datë 29.12.2020, ku është kërkuar implementimi i dy shërbimeve:

1. Aplikim për kualifikim si kandidat për pilot,
2. Aplikim për regjistrim dhe pajisje me certifikatë për pilot;

Ka dërguar në Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shkresën me nr. 5479.prot., datë 06.09.2022, rreth 1 vit e gjysmë me vonesë, në mos respektim të afateve ligjore.

Për sa më sipër nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk u konstatuan masa të marra në lidhje me vonesat e institucioneve në sjelljen e kërkesave me ndryshimet e përditësimet përkatëse në informacionin dhe formularin elektronik të publikuar.

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje të hartojë raporte monitorimi periodike në lidhje me institucionet shtetërore për respektimin nga ana e tyre ndaj afateve kohore për të mundur përditësimin e formularëve elektronikë sipas ndryshimeve të legjislacionit respektiv.

Në vijimësi

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjekti i audituar mbi projektraportin e dërguar.

Komente të paraqitura nga AKSHI

Sikurse kemi theksuar edhe gjatë paraqitjes së observacioneve të lëna nga grupi i auditimit të mëparshëm janë jashtë tagrit ligjor të AKSHI-t. AKSHI nuk ka tagër të kryej monitorimin e institucioneve të tjerë publikë apo marrja e masave ndaj tyre për rastet e mos zgjidhjes në kohë të kërkesave për suport për qytetarët.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Subjekti i audituar nuk ka ndërmarre asnjë hap për të zbatuar rekomandimin, sa me sipër pretendimi i dhënë nuk merret në konsideratë dhe statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2020-2022 janë një numër shumë i ulët i specialistëve në Sektorin e Asistencës të Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (8 specialistë) të cilët në bashkëpunim me institucionet shtetërore kanë trajtuar rreth 1,892,300 kërkesa të natyrave të ndryshme për zgjidhje dhe suport, mesatarisht në një ditë pune për

një punonjës rreth 2,389 ankesa/kërkesa, të cilat janë të pa evidentuar në një regjistër elektronik sipas tipologjisë, të cilat më pas Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje duhet të realizojë një analizë të performancës së sistemit të shërbimeve on-line.

6.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje të marrë masat për kategorizimin e ankesave dhe kërkesave për suport sipas llojit në një regjistër tip për analizimin dhe adresimin e tyre në institucionet përkatëse për zgjidhjen në kohën e duhur të ofrimit të shërbimeve on-line për qytetarët dhe bizneset.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegime të paraqitura nga AKSHI:

Sikurse kemi theksuar edhe gjatë paraqitjes së observacioneve të lëna nga grupi i auditimit të mëparshëm janë jashtë tagrit ligjor të AKSHI-t. AKSHI nuk ka tagër të kryej monitorimin e institucioneve të tjerë publikë apo marrja e masave ndaj tyre për rastet e mos zgjidhjes në kohë të kërkesave për suport për qytetarët.

AKSHI në bashkëpunim me ADB ka ngritur portalin shqipëria që dua dhe AKSHI bashkëpunon për të suportuar teknikisht ADB në rast nevoje nga kjo e fundit.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton **i pazbatuar**.

Komente të paraqitura nga AKSHI

AKSHI në bashkëpunim me ADB ka ngritur portalin shqipëria që dua dhe AKSHI bashkëpunon për të suportuar teknikisht ADB në rast nevoje nga kjo e fundit.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së:

Subjekti i audituar nuk ka dërguar asnjë dokumentacion mbi ndërrmarjen e hapava për zbatimin e këtij rekomandimi. Sa më sipër pretendimi i dhënë nuk merret në konsideratë dhe statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar.

7.Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe 75 institucione të administratës shtetërore nuk kanë bashkëvepruar për ngritjen e grupeve të punës në hartimin e planit të veprimit ndër institucional për transferimin nën administrimin nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të aseteve që preken nga fusha e veprimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke bërë që procesi i qendërimit të jetë në mospërputhje me afatet e përcaktuara. Aktualisht sistemet e IT dhe infrastruktura hardëare në këto institucione, janë ende pjesë e inventarit të tyre, e për pasojë edhe detyrimet juridike dhe financiare mbi këto sisteme.

7.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masat për përfundimin e procesit të kalimit të aktiveve të sistemeve të teknologjisë së informacionit në administrim fizik të tij në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe të njoftojë për ecurinë e tij periodikisht Kryeministrin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Shpjegime të paraqitura nga AKSHI:

Sqarojmë se, procesi iniciohet nga institucioni që e ka aktualisht në ngarkim sistemin elektronik dhe ky detyrim është që prej vitit 2017 me miratimin e VKM nr.673/2017, ku në pikën 18, të Kreut IV, përcaktohet shprehimisht se: “18. *Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018*”.

Jemi ende në proces dhe AKSHI është në pritje të vijimit të kalim kapitalit të sistemeve elektronike edhe në zbatim dhe përputhje të dispozitave ligjore të Ligjit nr.43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, të ndryshuar.

AKSHI në mënyrë të përsëritur ka dërguar kërksa tek të gjithë institucionet në varësi të KM kërkesë për plotësimin dhe zbatimin e VKM nr. 673/201. Pra, ky rekomandim është ende në proces.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton i pranuar dhe **i pazbatuar**.

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjekti i audituar mbi projektraportin e dërguar.

Komente të paraqitura nga AKSHI

Sqarojmë se, procesi iniciohet nga institucioni që e ka aktualisht në ngarkim sistemin elektronik dhe ky detyrim është që prej vitit 2017 me miratimin e VKM nr.673/2017, ku në pikën 18, të Kreut IV, përcaktohet shprehimisht se: “18. *Institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave duhet të dorëzojnë pranë AKSHI-t 1 (një) kopje të dokumentacionit të plotë të çdo sistemi dhe infrastrukture TIK ekzistuese dhe kodin e burimit. Sistemet dhe infrastruktura TIK ekzistuese kalojnë nën administrimin dhe inventarin e AKSHI-t, së bashku me të drejtat dhe detyrimet juridiko-civile përkatëse brenda datës 30 shtator 2018*”.

Jemi ende në proces dhe AKSHI është në pritje të vijimit të kalim kapitalit të sistemeve elektronike edhe në zbatim dhe përputhje të dispozitave ligjore të Ligjit nr.43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, të ndryshuar.

AKSHI në mënyrë të përsëritur ka dërguar kërksa tek të gjithë institucionet në varësi të KM kërkesë për plotësimin dhe zbatimin e VKM nr. 673/201. Pra, ky rekomandim është ende në proces.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Subjekti i audituar nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të zbatuar rekomandimin.

Sa më sipër pretendimi i dhënë nuk merret në konsideratë dhe statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar.

Nën pyetja 2.1.2: A kanë qenë eficiente investimet e kryera për ofrimin e shërbimeve në mënyrë elektronike në drejtim të reduktimit të kohës dhe kostove të shërbimeve?

8. Gjetje nga auditimi: Agjendat Digjitale janë dokumente të hartuara dhe paraqesin disa objektiva specifike, në disa raste të pashoqëruara me vlera investimesh apo burimin e financimit të tyre. Buxhetimi për këto agjenda paraqet luhatje midis viteve dhe financimi i parashikuar nuk gjendet i

shtrirë në mënyrë lineare. Ndërkohë monitorimet mbi ecurinë e planeve të veprimit nuk kanë qenë në nivelet e kërkuara për vlerësimin e realizimit të secilit objektiv, efektivitetin e tij ashtu dhe nevojën për plotësim apo ndryshim të tyre, çka e cenon procesin mbi destinacionin e fondeve financiare të dedikuara për realizimin e objektivave strategjike të vendosura.

8.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masat për ngritjen e një grupi ndër-institucional pune i cili të vlerësojë ecurinë faktike të agjendës digjitale për vitet 2022-2026, mbi fondet buxhetore të shpenzuara efektivisht.

Menjëherë

Shpjegime të paraqitura nga AKSHI :

Sikurse kemi sqaruar dhe më sipër AKSHI gjithmonë ka pasur dhe ka në fokus qasjen dhe përshtatjen e politikave dhe praktikave më të mira të rajonit në lidhje me zhvillimet inovative në fushën e teknologjisë së informacionit dhe qeverisjes elektronike në tërësi.

Në vitin 2018, AKSHI ka miratuar me Urdhër nr.6244, datë 07.11.2018 “Programin Kombëtar TIK 2018-2021”, i cili është hartuar për të siguruar vazhdimësinë e politikave ekzistuese TIK, për të përcaktuar prioritetet qeveritare në fushën TIK si dhe për të bashkërenduar strategjinë ndër-institucionale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike, për qytetarët, si dhe subjektet private për periudhën 2018 – 2021.

Draftimet e Agjendës Digjitale dhe planit të veprimit janë mbështetur dhe në këtë program, në cilësinë e një dokumenti strategjik institucional duke qënë se në të përfshihet vizioni, objektivat dhe masat për zbatimin e gjerë të TIK-ut në të gjitha fushat e jetës.

Drejtoria e Inovacionit dhe Promovimit të e-Gov e cila ishte përgjegjëse për monitorimin e realizimit të Agjendës Digjitale, ka ahartuar një raport-analizë për Programin Kombëtar TIK të cilin do ta gjeni bashkëlidhur të titulluar “Revolucioni digjital arritjet dhe sfidat”.

Lidhur me ndjekjen e zbatimit të Agjendës Digjitale 2015-2020, sqarojmë se për periudhën prill 2015- nëntor 2017 është ndjekur nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe për periudhën pasuese 2018-2020 është ndjekur nga AKSHI.

Janë hartuar raportet përkatëse Mars 2019, Dhjetor 2020 (përmbyllja e Agjendës 2015 – 2020) dhe Janar 2022 (raport monitorimi për planin e rishikuar të veprimit të agjendës digjitale vitin 2020-2022).

Ndërkohë lidhur me Agjendën 2022-2026 është hartuar Raporti i monitorimit për vitin 2022 (6-mujori), raporti i monitorimit për vitin 2023 dhe raporti i monitorimit për vitin 2024 (6 mujori) të cilat po ja u vendosim në dispozicion bashkëlidhur.

Theksojmë se, këto raporte janë hartuar në bashkëpunim me të gjitha institucionet kontribuese të përfshira në agjendë dhe në planin e veprimit.

Duke marrë parasysh rekomandimin tuaj dhe faktin që institucioni ynë planifikon të nisë punën për hartimin e Agjendës së re Digjitale gjatë vitit 2025, ju informojmë se do të ngremë një grup pune ndër-institucional me përfaqësues nga institucionet publike, por edhe nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit. Pas analizimit të monitorimeve, do të vlerësohet nevoja për kryerjen e propozimeve të sugjeruara nga ana juaj.

Grupi i punës do të analizojë mësimet e nxjerra nga zbatimi i Agjendës aktuale Digjitale për periudhën 2022-2026, duke evidentuar objektivat e arritura dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit të saj. Gjithashtu, do të vlerësojë progresin e arritur, bazuar në realizimin e indikatorëve të performancës dhe detyrat e parashikuara në planin e veprimit, si dhe të kryej një analizë mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe impaktin e tyre në transformimin digjital.

Bazuar në këtë analizë, grupi i punës do të përgatisë rekomandime për përcaktimin e objektivave të rinj dhe hartimin e hapave strategjike për Agjendën e re Digjitale. Kjo agjendë do të synojë fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve digjitale të institucioneve sidomos përmes integritit të teknologjive të reja, lehtësimin e mëtejshëm të aksesit të qytetarëve dhe bizneseve në shërbimet elektronike, si dhe përmirësimin e transparencës dhe efikasitetit të administratës publike.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton i pranuar dhe **i pazbatuar**.

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjekti i audituar mbi projektraportin e dërguar.

Komente të paraqitura nga AKSHI

Në vitin 2018, AKSHI ka miratuar me Urdhër nr.6244, datë 07.11.2018 “Programin Kombëtar TIK 2018-2021”, i cili është hartuar për të siguruar vazhdimësinë e politikave ekzistuese TIK, për të përcaktuar prioritetet qeveritare në fushën TIK si dhe për të bashkërenduar strategjinë ndërinstitucionale për ofrimin e shërbimeve elektronike në organet dhe institucionet e administratës publike, për qytetarët, si dhe subjektet private për periudhën 2018 – 2021.

Lidhur me ndjekjen e zbatimit të Agjendës Digjitale 2015-2020, sqarojmë se për periudhën prill 2015- nëntor 2017 është ndjekur nga Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe për periudhën pasuese 2018-2020 është ndjekur nga AKSHI.

Janë hartuar raportet përkatëse Mars 2019, Dhjetor 2020 (përmbyllja e Agjendës 2015 – 2020) dhe Janar 2022 (raport monitorimi për planin e rishikuar të veprimit të agjendës digjitale vitin 2020-2022).

Ndërkohë lidhur me Agjendën 2022-2026 është hartuar Raporti i monitorimit për vitin 2022 (6-mujori), raporti i monitorimit për vitin 2023 dhe raporti i monitorimit për vitin 2024 (6 mujori) të cilat po ja u vendosim në dispozicion bashkëlidhur.

Theksojmë se, këto raporte janë hartuar në bashkëpunim me të gjitha institucionet kontribuese të përfshira në agjendë dhe në planin e veprimit.

Duke marrë parasysh rekomandimin tuaj dhe faktin që institucioni ynë planifikon të nisë punën për hartimin e Agjendës së re Digjitale gjatë vitit 2025, ju informojmë se do të ngremë një grup pune ndërinstitucional me përfaqësues nga institucionet publike, por edhe nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit. Pas analizimit të monitorimeve, do të vlerësohet nevoja për kryerjen e propozimeve të sugjeruara nga ana juaj.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Subjekti i audituar nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të zbatuar rekomandimin.

Sa më sipër pretendimi i dhënë nuk merret në konsideratë dhe statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar.

9. Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit mbledh të ardhura nga dy shërbimet on-line (nënshkrimi elektronik dhe certifikata elektronike) të cilat për vitet 2020-2022 janë në total 992,997 mijë lekë, ndërsa investimet e kryera për mirëmbajtja e tyre për këto dy shërbime janë 113,746 mijë lekë ose sa 11% e të ardhurave të arkëtuara.

Me ndryshimet ligjore në dhjetor 2022, numri i bizneseve që duhet të marrin këto dy shërbime është rritur ndjeshëm në rreth 120,496 tatimpagues (sipas Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, viti 2022, www.tatime.gov.al) të cilët duhet të pajisen me nënshkrimin elektronik dhe certifikatën elektronike për çdo vit duke sjellë një fluks të shtuar të aplikimeve on-line gjë që duhet të ishte shoqëruar me një rritje të investimeve të Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në infrastrukturën aktuale PKI për të bërë të mundur shmangien e vonesave dhe penaltiteteve që bizneset mund të marrin nga mos pajisja me këto dy shërbime.

9.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të kryejë një analizë për rritjen e investimeve në përmirësimin e dy shërbimeve on-line (nënshkrimi elektronik dhe certifikata elektronike) si pasojë e shtimit të numrit të përdoruesve që marrin këto shërbime dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimit të ofruar. *Në vijimësi*

Komente nga subjekti i audituar:

Theksojmë se të ardhurat që vijnë nga dy shërbimet (nënshkrimi elektronik dhe certifikata elektronike) derdhen në buxhetin e shtetit sikurse përcaktohet dhe në mandatë arkëtimet e këtyre pagesave që u vihen në dispozicion aplikuesve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Lidhur me sa më sipër, rekomandimi rezulton i pranuar dhe **i pazbatuar**

Trajtimi i observacioneve/komenteve të paraqitura nga subjekti i audituar.

Komente të paraqitura nga AKSHI

Theksojmë se të ardhurat që vijnë nga dy shërbimet (nënshkrimi elektronik dhe certifikata elektronike) derdhen në buxhetin e shtetit sikurse përcaktohet dhe në mandatë arkëtimet e këtyre pagesave që u vihen në dispozicion aplikuesve.

Qëndrimi i audituesve të KLSH-së

Subjekti i audituar nuk ka ndërmarre asnjë hap të zbatuar rekomandimin, sa me sipër pretendimi i dhene nuk merret ne konsiderate dhe statusi i rekomandimit qëndron i pandryshuar.

VI. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME:

Në përfundim të procesit të auditimit, mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH të përcjella me shkresën nr. 443/6 prot., datë 27.12.2023 konstatohet se një pjesë e madhe e tyre paraqitet e pazbatuar ose pjesërisht i zbatuar. Duke parë punën e pamjaftueshme të bërë në drejtim të zbatimit të tyre, **ri-kërkojmë** zbatimin e rekomandimeve, si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

Pyetje e auditimit 1.1 A kanë prodhuar politikat e ndërmarra një mekanizëm efektiv për ofrimin e shërbimeve on line për qytetarët dhe bizneset?

Nën pyetja 1.1.2: A janë të mirë përcaktuara rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve publike në ofrimin e shërbimeve on line?

1.Gjetje nga auditimi: Për periudhën në auditim për vitet 2020-2022 krahas punës së bërë në përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të institucioneve publike në ofrimin e shërbimeve on line për disa institucione u konstatua :

- Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit me gjithë marrjen e masave të vazhdueshme për rritjen e numrit të vendeve të punës, vijon të ketë mangësi të burimeve njerëzore dhe ekspertë të fushës,
- mos përditësimi i rregullores së brendshme, me ndryshimet përkatëse të strukturës,
- mos pajisja me Certifikatën e Sigurimit e gjithë punonjësve të cilët përpunojnë informacionin e klasifikuar,
- mos kryerja e trajnimeve të vazhdueshme të stafit në përshtatje me njohuritë e fundit të teknologjisë digjitale.

1.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masa të plotësojë të gjitha vendet bosh të punës sipas organikës së institucionit, për përditësimin e rregullores së brendshme dhe të hartojë planin vjetor të trajnimeve për zhvillimin e burimeve njerëzore me tema të mirë përcaktuara, sipas zhvillimit të teknologjisë dhe për gjithë punonjësit.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Monitorimi deri në muajin shtator të vitit 2022, për ofrimin e shërbimeve publike on-line nga institucionet shtetërore, të cilat ndër veprojnë në platformën e-Albania, sipas Sistemit të Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik, e kanë realizuar vetë institucionet jo në koordinim me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

2.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Informacionit dhe Komunikimit të shtojë bashkëpunimin me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, për monitorimin e vazhdueshëm të shërbimeve publike të ofruara nga institucionet shtetërore.

Në vijimësi

Pyetje e auditimit 2: A kanë mbështetur masat organizative dhe teknike zbatimin e plotë të mekanizmit të marrjes së shërbimeve publike on-line për qytetarët dhe bizneset?

Nën pyetja 2.1.1: A janë marrë masat e nevojshme nga institucionet publike për të garantuar ofrimin efektiv të shërbimeve on-line?

3. Gjetje nga auditimi: Gjatë procesit të digjitalizimit janë ngritur 2 sisteme të reja që i përkasin shërbimeve që ofron Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe për 8 institucionet e tjera janë kryer përmirësime të sistemeve elektronike ekzistuese për të cilat nuk rezultojnë të ketë informacion të detajuar në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit në lidhje me përshtatjen në infrastrukturën përkatëse TIK të cilat mund të sjellin mangësi në monitorimin e efektivitetit të këtyre sistemeve si edhe në zgjidhjen në kohë reale të problematikave për shërbimet e ofruara on-line.

- Nga institucionet shtetërore nuk janë përcjellë kërkesa në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për nevojat e tyre për projektet dhe pajisjet TIK për vitin pasardhës, sipas afateve ligjore, të çdo viti.

3.1Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të hartojë raporte periodike 3 mujore mbi ecurinë dhe përshtatjen e përmirësimeve që kryhen në sistemet TIK nga institucionet që ofrojnë shërbime të ndryshme on-line ndaj qytetarëve dhe të njoftojë Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Në vijimësi

4.Gjetje nga auditimi: Në lidhje me korrespondencën shkresore të institucioneve shtetërore me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit u konstatuan:

-Mos respektimi i afateve ligjore në kohë në lidhje me detyrimin që institucionet shtetërore kanë për sjelljen e ndryshimeve ligjore të cilat duhet të reflektohen në formularin elektronik nga Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, që të mos penalizohen qytetarët dhe bizneset. Konkretisht:

- Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, ka dërguar me rreth 2 vite vonesë formatin elektronik për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore nga dalja e Urdhrit nr. 284, datë 07.10.2020 “Për miratimin e lejes së re të qarkullimit të mjeteve rrugore”;

- Drejtoria e Përgjithshme Detare ka përcjellë shkresën me nr. 7997.prot., datë 21.12.2022, në zbatim të Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2022 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Për përditësimin e shërbimit që lidhet me aplikimin për regjistrim dhe pajisje me pasaportë detare dhe aplikimin për regjistrim dhe pajisje me pasaportë detare për shtetas shqiptarë, të huaj, pa shtetësi” rreth 6 muaj me vonesë;

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në zbatim të urdhrat të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 61, datë 05.06.2012, i rishikuar me urdhrat nr. 432/1, datë 17.02.2017 dhe nr. 392, datë 29.12.2020, ku është kërkuar implementimi i dy shërbimeve:

Aplikim për kualifikim si kandidat për pilot,

Aplikim për regjistrim dhe pajisje me certifikatë për pilot;

Ka dërguar në Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, shkresën me nr. 5479.prot., datë 06.09.2022, rreth 1 vit e gjysmë me vonesë, në mos respektim të afateve ligjore.

Për sa më sipër nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit nuk u konstatuan masa të marra në lidhje me vonesat e institucioneve në sjelljen e kërkesave me ndryshimet e përditësimet përkatëse në informacionin dhe formularin elektronik të publikuar.

4.1Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje të hartojë raporte monitorimi periodike në lidhje me institucionet shtetërore për respektimin nga ana e tyre ndaj afateve kohore për të mundur përditësimin e formularëve elektronikë sipas ndryshimeve të legjislacionit respektiv.

Në vijimësi

5.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2020-2022 janë një numër shumë i ulët i specialistëve në Sektorin e Asistencës të Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (8 specialistë) të cilët në bashkëpunim me institucionet shtetërore kanë trajtuar rreth 1,892,300 kërkesa të natyrave të ndryshme për zgjidhje dhe suport, mesatarisht në një ditë pune për një punonjës rreth 2,389 ankesa/kërkesa, të cilat janë të pa evidentuar në një regjistër elektronik sipas tipologjisë, të cilat më pas Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje duhet të realizojë një analizë të performancës së sistemit të shërbimeve on-line.

5.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në bashkëpunim me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje të marrë masat për kategorizimin e ankesave dhe kërkesave për suport sipas llojit në një regjistër tip për analizimin dhe adresimin e tyre në institucionet përkatëse për zgjidhjen në kohën e duhur të ofrimit të shërbimeve on-line për qytetarët dhe bizneset.

Menjëherë dhe në vijimësi

6.Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe 75 institucione të administratës shtetërore nuk kanë bashkëvepruar për ngritjen e grupeve të punës në hartimin e planit të veprimit ndër institucional për transferimin nën administrimin nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të aseteve që preken nga fusha e veprimit të Vendimit të Këshillit të

Ministrave nr. 673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke bërë që procesi i qendërimit të jetë në mospërputhje me afatet e përcaktuara. Aktualisht sistemet e IT dhe infrastruktura hardëare në këto institucione, janë ende pjesë e inventarit të tyre, e për pasojë edhe detyrimet juridike dhe financiare mbi këto sisteme.

6.1. Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masat për përfundimin e procesit të kalimit të aktiveve të sistemeve të teknologjisë së informacionit në administrim fizik të tij në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse dhe të njoftojë për ecurinë e tij periodikisht Kryeministrin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Nën pyetja 2.1.2: A kanë qenë eficiente investimet e kryera për ofrimin e shërbimeve në mënyrë elektronike në drejtim të reduktimit të kohës dhe kostove të shërbimeve?

7.Gjetje nga auditimi: Agjendat Digjitale janë dokumente të hartuara dhe paraqesin disa objektiva specifike, në disa raste të pashoqëruara me vlera investimesh apo burimin e financimit të tyre. Buxheti për këto agjenda paraqet luhatje midis viteve dhe financimi i parashikuar nuk gjendet i shtrirë në mënyrë lineare. Ndërkohë monitorimet mbi ecurinë e planeve të veprimit nuk kanë qenë në nivelet e kërkuara për vlerësimin e realizimit të secilit objektiv, efektivitetin e tij ashtu dhe nevojën për plotësim apo ndryshim të tyre, çka e cenon procesin mbi destinacionin e fondeve financiare të dedikuara për realizimin e objektivave strategjike të vendosura.

7.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të marrë masat për ngritjen e një grupi ndër-institucional pune i cili të vlerësojë ecurinë faktike të agjendës digjitale për vitet 2022-2026, mbi fondet buxhetore të shpenzuara efektivisht.

Menjëherë

8.Gjetje nga auditimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit mbledh të ardhura nga dy shërbimet on-line (nënshkrimi elektronik dhe certifikata elektronike) të cilat për vitet 2020-2022 janë në total 992,997 mijë lekë, ndërsa investimet e kryera për mirëmbajtja e tyre për këto dy shërbime janë 113,746 mijë lekë ose sa 11% e të ardhurave të arkëtuara.

Me ndryshimet ligjore në dhjetor 2022, numri i bizneseve që duhet të marrin këto dy shërbime është rritur ndjeshëm në rreth 120,496 tatimpagues (sipas Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, viti 2022, www.tatime.gov.al) të cilët duhet të pajisen me nënshkrimin elektronik dhe certifikatën elektronike për çdo vit duke sjellë një fluks të shtuar të aplikimeve on-line gjë që duhet të ishte shoqëruar me një rritje të investimeve të Agjencisë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit në infrastrukturën aktuale PKI për të bërë të mundur shmangien e vonësive dhe penaltiteteve që bizneset mund të marrin nga mos pajisja me këto dy shërbime.

8.1 Rekomandimi: Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, të kryejë një analizë për rritjen e investimeve në përmirësimin e dy shërbimeve on-line (nënshkrimi elektronik dhe certifikata elektronike) si pasojë e shtimit të numrit të përdoruesve që marrin këto shërbime dhe përmirësimin të cilësisë së shërbimit të ofruar.

Në vijimësi

Për sa më sipër mbahet ky Raport Auditimi.

KLSEH